

1. Ku do të zhvillohen trajnimet, do të jetë online, në ambjentet e trajnuesit apo në shkollë)

Trajnimi do të organizohet i përbashkët në një vendndodhje të përshtatshme për udhëtimin e të gjithë pjesëmarrësve. Kontraktori është përgjegjës sipas listës së mësuesve për kostot e udhëtimit, fjetjen, dietat e pjesëmarrësve, gjithashtu për kostot e vendit të organizimit si dhe kosto të tjera logjistike të lidhura me këtë trajnim.

2. A lejohet me qene ne bashkëpunim me një kompani lokale (Tirane)?

Po. Projekti S4J inkurajon bashkëpunimin me kompani lokale, rajonale apo ndërkombëtare, të cilat zotërojnë kapacitet për kryerjen me sukses të një detyre të caktuar. Projekti nxit promovimin dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale në Shqipëri, në nivel kombëtar dhe veçanërisht në nivel rajonal.

3. A do të mbahen trajnimet ne Tirane apo ne te gjitha qendrat e cekura?

Trajnimi duhet të zhvillohet i përbashkët për të gjithë institucionet. Nuk është e domosdoshme që trajnimi të organizohet në Tiranë, vende të cilat lejojnë udhëtimin sa me të lehtë të pjesëmarrësve janë të rekomanduar.

4. Trajnimet ne gjuhen Shqipe por materiali, kurikula shqip apo anglisht?

Te gjitha materialet e trajnimit duhet të jenë në gjuhën Shqipe, duke mos përfshirë një pjesë të terminologjisë e cila nuk mund të përkthehet.

5. A do duhet te zhvillohet libër/material trajnues i detajuar i cili do te implementohet ne ligjërim tek nxensit?

Ashtu siç specifikohet dhe në Kërkesën për Propozim materialet e zhvilluara për këtë trajnim duhet të jenë gjithashtu të përshtatshme për mësuesit për të përçuar kompetenca tek nxënësit, dhe të përdorshme në klasë. Çdo material i zhvilluar më tepër konsiderohet një avantazh.

6. A është parapar qe Instruktorët te paisjen me certifikimet Internacinele/industriale ne profilet gjegjëse apo certificate lokale interne, te përfundimit te puntoris?

Nuk është e nevojshme për të pajisur pjesëmarrësit me certifikata ndërkombëtare. Një certificate pjesëmarrje duhet të shpërndahet në fund të trajnimit. Gjithsesi, përbëjnë avantazh certifikime si profesionistë dhe si instruktor i stafit të kompanisë kontraktore.

7. Nga sa pjesmarres do te janë ne profile perkatse?

Kjo do të vendoset para fillimit të vitit shkollor. Ne do të sigurojmë informacion sapa të jetë i disponueshëm nga shkollat e përfshira.

8. A do mbahen trajnimet ne bllok apo me ndërprerje ditore?

Trajnimet duhet të zhvillohen në blloqe për të mos u bërë pengesë për procesin mësimor.

9. A keni ndonjë format te posaqem ne përshkrimin e ofertës financiare?

Jo. Por një propozim sa më i detajuar përbën avantazh.

10. A do të mbështetet infrastruktura e trajnimit nga projekti apo nga kontraktori I përzgjedhur (Laborator Kompjutra, kompjutera të tjere për testim, pasije rrjeti, etj.)?

Çdo aspekt I logjistikës duhet të merret përsipër nga kontraktori, duke përfshirë pajisjet fundore për përdoruesit, apo çdo pajisje tjetër për demonstrim apo përdorim.

11. A do të zhvillohet kurrikula e detajuar si pjese e propozimit apo pas vlerësimit të nevojave me mësuesit?

Po, kurrikula e trajnimit, programi, apo temat do të zhvillohen pas një analize të nevojave për njohuri në temat e reja apo tema të cilat kanë nevojë për vëmendje nga mësuesit e përfshirë.

12. Cilat janë arritjet kryesore të projektit, duke patur parasysh se viti I ri akademik fillon në Shtator?

Qëllimi kryesor për në shtator është në trajnimin e parë të përfshihen njohuritë e nevojshme për tre mujorin e pare të vitit të ri akademik.

13. Ka ndonjë kufizim në buxhet? Nëse po, cila eshte vlera maksimale?

Jo, nuk ka kufizime në buxhet. Vlerësimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe peshave të përcaktuara në kërkesën për propozim.

14. Është e rëndësishme për ne të kuptojmë nëse pjesëmarrja e mësuesve është e detyrueshme apo fakultative.

Po, pjesëmarrja do të jetë e detyruar për mësuesit nga drejtuesit e institucioneve.

15. A janë caktuar kreditet qe do të ketë ky trajnim? A duhet të propozojmë ne numrin e krediteve dhe orëve te trajnimit apo do te caktohet nga ju?

Jeni të mirëpritur të sugjeroni numrin e krediteve/orëve të trajnimit si dhe ideve në bazë të ekspertizës suaj. Ju lutem referojuni paragrafit mbi kalendarin e trajnimit (fq.4) në kërkesën për ofertë te publikuar për orientim.